



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.120/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 30.09.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.120/2019 e datës 28.09.2019, e paraqitur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Prishtinë.

### A r s y e t i m

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP më datë 28.09.2019, me të cilën pretendon se nga ana e subjektit politik Lista Serbe, më datë 27.09.2019, në komunën e Zveçanit, në vendin e quajtur Obdaniste “LANE” Zvecan, është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr.13/2013, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019, për “*Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike*”, respektivisht neni 5 par.2,3 dhe 4 i rregullës në fjalë, ashtu që nga ana e këtij subjekti, gjatë fushatës zgjedhore janë përdorur fëmijë nën moshën 15 vjeç, gjë kjo e cila është vërejtur gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore nga ana e KDI-së.

Paraqitësi i ankesës si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur disa fotografi.

Në përgjigje në ankesë të datës 30.09.2019, subjekti politik Lista Serbe, lidhur me pretendimet ankimore të KDI-së, ka theksuar se të njëjtat janë absolutisht të pabazuara, sepse më datë 27.09.2019, në lokacionin e theksuar nga paraqitësi i ankesës, subjekti politik Lista Serbe nuk ka organizuar dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë aktivitet të lidhur me fushatë për Zgjedhjet e Përgjithshme të Jashtëzakonshme. Lidhur me fotografitë të cilat paraqitësi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës, subjekti politik Lista Serbe thekson se nga to nuk mund të konstatohet se në atë lokacion ka pasur tubim politik. Më tej ka shtuar se atë ditë, kopshti “LANE”, ka festuar ditëlindjen e saj, festë e cila festohet tradicionalisht nga ana e tyre tash e disa vite, me ç’rast atë ditë janë hapur hapësirat e reja të kopshtit që ka financuar komuna e Zveçanit. Sa i përket aktivitetit të këtij event, subjekti politik në fjalë ka theksuar se ky ka qenë një event ku fëmijët e kopshtit “LANE”, kanë përgatitur program me këngë dhe recitime

në mënyrë që të madhështonin ngjarjen, ka pasur edhe fjalime të mbajtura nga ana e kryetarit të komunës së Zveçanit dhe bamirës të tjerë të cilët kanë ndihmuar në ndërtimin e pjesës së re të këtij kopshti, ngjarje kjo e cila sipas tyre nuk mund të lidhet në asnjë mënyrë me fushatë zgjedhore. Në fund i ka propozuar PZAP-it, që ankesa e KDI-së, të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se paraqitësi i ankesës nuk ka arritur që me sukses t'i argumentojë pretendimet e veta, pasi që nga fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, nuk shihet që subjekti politik Lista Serbe ka promovuar program politik duke përfshirë fëmijë nën moshën 15 vjeçare në fushatë zgjedhore. Nga fotografitë vërehet vetëm se është mbajtur një tubim, në të cilin kanë qenë prezent edhe fëmijë të mitur, por nuk ka dëshmi se ky event ka qenë tubim politik, pasi që nga fotografitë nuk shihet se aty ka pasur materiale promovuese të subjektit politik Lista Serbe.

Pretendimet ankimore të paraqitësit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregullën Zgjedhore Nr.20/2019, për "Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike", respektivisht nenin 5 par.2,3 dhe 4 të rregullës në fjalë, nga ana e subjektit politik Lista Serbe, Paneli vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore, me të cilat sanksionohet pjesëmarrja në fushatë zgjedhore e personave të cilët nuk i kanë mbushur 15 vjeç. Andaj në mungesë të provave, paneli e refuzoi ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.120/2019 më datën 30.09.2019

**Kryesuesi i Panelit**

Zyhdi Haziri



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.